



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDIANA L. IBRAJ
ADRESA KAMEZ, BLV"BLU", NR.406
TEL: 694052125

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2224

Nr. koleksioni: 1011

Tirane më 03/06/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021050340104995694



A2021050340104995694

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË “ASTRA COLOR“ Sh.p.k.)

Sot, më datë 03.06.2021, para meje Notere ARDIANA L. IBRAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, KAMEZ, BLV"BLU", NR.406, u paraqit personalisht:

SHITES: 1. **Elton Bitri**, atësia Ruzhdi, amësia Ruzhdie, shtetas Shqiptar, lindur në Bllaçë, Dibër dhe banues në TIRANË, me adresë Mareja 03920187; Nd. 4; H. 1; Kashar; Mëze; 1050; Tiranë, lindur më 21/07/1984, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. personal I40721109K

Jep pelqimin bashkeshortja Arjola Bitri, atësia Nazmi, amësia Nadire, shtetase Shqiptare, lindur në Burrel dhe banuese në TIRANË, me adresë Mareja 03920187; Nd. 4; H. 1; Kashar; Mëze; 1050; Tiranë, lindur më 15/09/1988, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. personal I85915008I

BLERES: 1. **Rruzhdie Bitri**, atësia Elmas, amësia Safije, shtetase Shqiptare, lindur në Fush Çidhën, Dibër dhe banuese në TIRANË, me adresë Mareja 03920187; Nd. 4; H. 1; Kashar; Mëze; 1050; Tiranë, lindur më 25/03/1964, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. personal G45325145V

2. Erion Bitri, atësia Ruzhdi, amësia Ruzhdie, shtetas Shqiptar, lindur në Bllaçë, Dibër dhe banues në TIRANË, me adresë Mareja 03920187; Nd. 4; H. 1; Kashar; Mëze; 1050; Tiranë, lindur më 09/06/1992, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. personal J20609106N.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “ASTRA COLOR“ Sh.p.k , sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

NENI 1**KUSHTET PARAPRAKE**

Kushtet paraprake te mesiperme jane pjese thelbësore dhe integruese e kesaj kontrate.

NENI 2**SHITJA E KUOTES**

Fq. 1



A2021050340104995694

- 2.1 Shitesi **Z.Elton Bitri**, deklarohet se është ortak dhe zoterues i 100% të kapitalit të shoqërisë **“ASTRA COLOR“ Sh.p.k.** me 1(një) kuotë për vlerën 100.000 leke, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e regjistruar pranë QKB me NIPT M01414005V dhe ka selinë në adresën, Bulevardi Blu Pallati Ana Konstruksion Nr.162/124, Kati 1.
- 2.2 Nepermjet kësaj kontrate Shitesi i shet dhe i transferon Bleresëve dhe keto të fundit pranojnë dhe blejnë kuotën me vlerën nominale 40.000 (dyzet mijë) leke, kjo në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë kontratë.
- 2.3 Çmimi i kontratës është për vlerë 40.000 (Dyzet mijë leke) leke, është likuiduar jashtë kësaj zyre para nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 2.4 Kuotat e aksioneve ndahen si më poshtë:
- z.Elton Bitri 60% të kuotave me vlerë 60.000 leke
 - znj.Rruzhdie Bitri 20% të kuotave me vlerë 20.000 leke
 - z.Erion Bitri 20% të kuotave me vlerë 20.000 leke

NENI 3

DEKLARIME DHE GARANCI

- 3.1 Shitesi deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar dhe titullar i kuotës dhe i të drejtave që rrjedhin prej saj.
- 3.2 Shitesi deklaron dhe garanton se kuotat janë teresisht të lira nga çdo peng, privilegj, barre siguruese, detyrim, garanci apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tjerëve. Se ka përfunduar procesin e transferimit dhe mban përgjegjësi dhe detyrim ligjor për çdo veprim të kryer deri sot.
- 3.3 Aksionet shiten vetëm brenda ortakeve. Në rast se aksionerët do të shesin aksionet e tyre ata duhet një njoftojnë shoqërinë të paktën 6 muaj para se të kryhet shitja. Pas kësaj periudhe janë të lire të shesin aksionet e tyre. Njoftimi duhet bërë me shkrim dhe të jenë me leter rekomandë dhe kthim përgjigje.
- 3.4 Palet bien dakort se në rast shitje të aksioneve duhet miratimi me shkrim i z.Elton Bitri. Miratimi duhet të kryhet 6 muaj para se të ndodhi shitja e këtyre aksioneve.
- 3.5 Palet bien dakort që drejtimin e shoqërisë do të vazhdojë ta kryej z.Elton Bitri.

NENI 4

TE TJERA

- 4.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet ndërmjet Paleve duhet të behen me shkrim dhe të dorëzohen pranë selisë së regjistruar të Bleresit dhe të Shitesit, njoftimet do të jenë me leter rekomandë dhe kthim përgjigje.
- 4.2 Bleresi përfitues i kuotës pavarësisht çmimit të blerjes në marrëveshje me paleve, bazuar në ligje përgjigjet pasketaj personalisht për çdo veprim lidhur me kuotën në fjalë dhe vlerën totale të kapitalin nominal të shoqërisë.

NENI 5

ZGJIDHJA E MOSMARRËSHJES

Palet angazhohet të zgjidhin me mirkuptim çdo mosmarrëshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj kontrate dhe vetëm kur një zgjidhje e tillë nuk është e mundur mosmarrëshja do të kalojë për zgjidhje në Gjykatën kompetente Tiranë.

NENI 6

E DREJTA E ZBATUESHME

Kjo kontratë do të rregullohet në bazë të së drejtës shqiptare në fuqi.

NENI 9

Fq. 2



A2021050340104995694

ANEKSET E KONTRATËS

9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneke të Kontratës;

- Vendimi i ortakut të vetëm
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë “ASTRA COLOR“ Sh.p.k
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

NENI 10

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Elton Bitri

Arjola Bitri

Rruzhdie Bitri

Erion Bitri

Notere

ARDIANA L. IBRAJ

